



AVOKATI I POPULLIT

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT

Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës,
trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues

Tel/Fax:+355 4 2380 300/323
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot. Tiranë ___/___/2021
Nr. Dok. 202101074/2

Lënda: *Rekomandohet përmirësimi i menjëherëshëm i kushteve dhe i trajtimit të të dënuarve dhe paraburgosurve në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale në IEVP-së Burrel.*

Drejtuar: **Z. Agim ISMAILI**
Drejtor i Përgjithshëm i Burgjeve

TIRANË

Z. Dylejman HYSA
Drejtor i Institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale (I.E.V.P.)

BURREL

Të nderuar,

Mekanizmi Kombëtar për parandalimin e torturës, trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues në vijim Mekanizmi Kombëtar ose MKPT, seksion pranë Avokatit të Popullit, bazuar në neni 19/1 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999, "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar dhe neni 81 të ligjit nr.81/2020 "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve", kreu një inspektim në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale Burrel më datë 28.07.2021, sipas një Plani Inspektimi të miratuar nga Avokati i Popullit. Në përbërje të grupit inspektues ishin znj. Nertila Qafzezi, znj. Gloria Çarkaxhiu, z. Besnik Deda dhe z. Hazbi Selita me detyrë nd/ komisionerë pranë këtij Mekanizmi Kombëtar.

Objektivi kryesor i kësaj vizite monitoruese ishte vlerësimi i kushteve të Institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale në Burrel, cilësia e trajtimit të të dënuarve dhe paraburgosurve brenda tij, si dhe masat e marra për zbatimin e rekomandimeve të Avokatit të Popullit të bëra gjatë inspektimeve të mëparshme. Vizita në këtë institucion u zhvillua në një frymë të mirë bashkëpunimi. Grupi i inspektimit të Avokatit të Popullit u takua fillimisht me drejtorin e institucionit z. Dylejman Hysa. Nga ana e drejtuesit të këtij institucioni, grupit inspektues iu garantua mundësia që të kishin akses në përputhje me Rregulloren e Përgjithshme të Burgjeve, për të kryer vizita në të gjithë ambientet që duhet të monitoronin, si dhe për zhvillimin e takimeve dhe intervistave konfidenciale me personat e dënuar/ paraburgosur.

Gjithashtu grupi inspektues i Mekanizmit Kombëtar përgjatë inspektimit i kushtoi vëmendje të veçantë dhe masave të marra nga institucioni mbi parandalimin e përhapjes së virusit Covid-19.

Sipas informacionit dhe nga verifikimi i këtyre masave, rezultoi se zbatohet protokollin shëndetësor për masat anti Covid-19. Në hyrje të institucionit, punonjësi i shërbimit kryente matjen e temperaturës me termometër digital, si dhe kalohej në urën dezinfektuese, duke evidentuar të dhënat në një libër të veçantë për çdo punonjës dhe vizitor.

Personeli i institucionit, zbatonte me korrektesë masat mbrojtëse, në ambientet e punës me mbajtjen e maskave, duke ruajtur distancimin fizik dhe social, si dhe në mbajtjen e higjienës personale.

Urdhërat, udhëzimet dhe protokollet shtesë të Ministrisë së Shëndetësisë, ishin të afishuar në hyrje të institucionit, zyrat e administrates dhe në hyrje të regjimit të brendshëm.

Ishin shmangur ose minimizuar grumbullimet e stafit në rreshtime, mbledhje dhe kontaktet me të dënuarit dhe njëkohësisht ishin dhënë porosi të dënuarve dhe të paraburgosurve, që mos të krijoheshin grumbullime gjatë orareve të veprimeve të përbashkëta.

Personeli shëndetësor i institucionit për kontrollin e menaxhimin e gjendjes shëndetësore të të dënuarve dhe të paraburgosurve, një herë në javë kishte ushtruar kontrole mjekësore, rezultatet e të cilave ishin evidentuar në libra të veçantë.

Të dënuarit dhe të paraburgosurit të cilët për arsye shëndetësore kishin shkuar në urgjencën e spitalit apo në klinikë private stomatologjike, pas kthimit në institucion ishin karantinuar 14 ditë (Urdhër i Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve) në sektorin e observimit, sipas protokollit shëndetësor. Afati i karantinimit kishte mbetur i pandryshuar nga nisja e zbatimit të masave të reja.

Masa më e rëndësishme është se, që në fillim të pandemisë ishin ndërprerë takimet me familjarë dhe ishte lejuar vetëm sjellja e ushqimeve, të cilat pasi kontrolloheshin, më pas mbaheshin 4 orë pa ju dorëzuar të paraburgosurve, si kusht i protokollit, që edhe ushqimet të mos shërbejnë si transmetues të infeksioneve. Në ditën e inspektimit 17.06.2021 konstatoam se prej dates 14 Qershor në I.E.V.P. Burrel kishin rifilluar takimet me familjarët kjo sipas Urdhërit të Ministrisë së Drejtësisë Nr.6285/1 datë 11.06.2021 “*Për zbatimin e masave për parandalimin e përhapjes së infeksionit të shkaktuar nga Covid-19 në institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale*”.

Lehtësimi i masave kufizuese në sistemin e burgjeve, është fokusuar në tre drejtime:

1. Rifillimi i kufizuar të takimeve me familjarët, dhe të afërmeve të tyre.
2. Rifillimi i dhënies së lejeve të veçanta.
3. Si dhe rifillimi i aktivitetet sociale dhe kulturore, në institucionet penitenciare.

Konkretisht, masat e reja kanë filluar të zbatohen nga data 14 qershor për një periudhë e cila do të jetë nën monitorim të vazhdueshëm nga të gjitha strukturat shëndetësore dhe ekipi drejtues i DPB-së dhe i burgjeve. Këto masa konsistojnë konkretisht:

1. Rifillimin e lejimit të takimeve të të dënuarve me familjarët, me një takim në muaj duke respektuar distancën e sigurisë, kontrollin shëndetësor, ku familjari është i

detyruar të paraqesë vërtetimin e vaksinimit, ose dokumentin e testit negativ me Covid, me afat 24 orë para apo teste të tjera serologjike që tregojnë se e kanë kaluar infeksionin e Covidit. Gjatë takimeve do të respektohen të gjitha rregullat e tjera antikovid në institucione që do të jenë ende në fuqi. Por gjithashtu do të vijojnë të ruhet praktika e krijuar me komunikimin online me Skype.

2. Rifillimin e dhënies së lejeve të veçanta, në zbatim edhe të udhëzimit të miratuar së fundmi në zbatim të ligjit të ri nr. 81/2020, Udhëzim nr.4, datë 22.01.2021 i ministrit të Drejtësisë, “Për përcaktimin e procedurave të dhënies së lejeve shpërblyese apo të veçanta për të dënuarit”, por kjo situatë do të jetë vetëm për raste mortore gjithmonë sipas parashikimeve ligjore dhe vlerësimit të rrezikshmërisë nga drejtoritë e policisë vendore.
3. Rifillimin e aktiviteteve të përbashkëta, sociale dhe kulturore në mjediset e burgjeve, kjo do të kryhet duke mbajtur në konsideratë dhe duke respektuar distancën e sigurisë dhe rregullat e tjera antikovid, por me qëllim që ti shërbejë rehabilitimit dhe riedukimit të të gjithë personave të cilët ndodhen në institucione, do duhet të rifillojnë këto aktivitete.

Sipas informacionit të marrë “të gjitha parashikimet e tjera ligjore lidhur me masat e tjera antikovid të parashikuara në urdhërat nr. 91 dhe 92 të datës 09.03.2020 të Ministrit të Drejtësisë do të vijojnë të jenë në fuqi”.

Institucioni i Avokatit të Popullit, pasi u njoh me konstatimet e grupit inspektues, ka të drejtën e detyrimit kushtetues dhe ligjor t’ju parashtrijë gjetjet e këtij inspektimi dhe të bëjë rekomandimet përkatëse.

Shënime të përgjithshme

Kjo ishte vizitë periodike monitoruese e Avokatit të Popullit në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale Burrel për vitin 2021. Drejtori i institucionit z. Dylejman Hysa, pasi u njoh me planin e inspektimit, informoi lidhur me kushtet e trajtimit dhe situatën e respektimit të të drejtave të dënuarve/paraburgosurve në këtë institucion. Në vijim, grupi inspektues kërkoi nga shefat e sektorëve dhe të shërbimeve, vënien në dispozicion të kopjeve të dokumentacionit lidhur me organikën, programet vjetore të punës dhe aktiviteteve të sektorit juridik, sektorit të kujdesit dhe shërbimit social, të shërbimit shëndetësor, sektorit të policisë, etj.

Grupi i inspektimit u informua se në bazë të Urdhrit të Ministrit të Drejtësisë nr.8927/1, datë 27.09.2018, “Për klasifikimin e institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale”, Institucioni i Ekzekutimit të Vendimeve Penale Burrel është kategorizuar si burg i sigurisë së lartë, me një seksion për të dënuar të sigurisë së lartë, me një seksion për të dënuar të sigurisë së zakonshme dhe një seksion për të paraburgosur.

Ky institucion ka një kapacitet maksimal prej 196 personash. Seksioni i sigurisë së lartë ka kapacitet prej 28 persona, ndërsa seksioni i sigurisë së zakonshme ka kapacitet 96 persona, seksioni i paraburgimit ka kapacitet 72 persona. Në ditën e inspektimit, në mjediset e institucionit ndodheshin 152 persona, nga të cilët 80 të paraburgosur, 44 të dënuar siguri e zakonshme dhe 28 të dënuar siguri e lartë. Institucioni nuk kishte Sektor

të Kujdesit të Veçantë (SKV). Aktualisht në I.E.V.P. Burrel ndodhen dy sektorë të sigurisë së zakonshme (sektorin A dhe sektorin B), sektori A me kapacitet 40 shtretër dhe sektori B me kapacitet 40 shtretër. Sektori ku dhe ndodheshin 25 të dënuar të sigurisë së zakonshme ishin akomoduar në sektorë të tjerë. Përgjatë inspektimit u informuam se sektori i sigurisë së zakonshme B ishte duke u përshtatur në sektor të sigurisë së lartë ku pritej pas përshtatjes së ambienteve të akomodoeshin 20 deri 25 persona të sigurisë së lartë, ky sektor kishte 8 dhoma akomodimi të përmasave që variojnë nga 20 deri 21 m². Ky shtim i numrit të sektorëve apo nën ndarjet e tij, kishte sjellë dhe mbipopullim të dhomave të banimit në sektorët e tjerë të I.E.V.P-së ku disa prej tyre kishin 6-8 banorë mbi kapacitetin e lejuar. Tejkalimi i normës prej 4m² hapësirë jetike për person, e cila konsiderohet si shkelje e standardit të sipërfaqes së banimit për person, si dhe trajtim degradues e jo njerëzor.¹ Shkelja e këtij standardi është evidentuar edhe nga Komiteti për Parandalimin e Torturës (CPT) me rastin e vizitave monitoruese në Shqipëri, i cili në përfundim të vizitës ka rekomanduar autoriteteve Shqiptare se: *“Të dënuarit/paraburgosurit të akomodohen në dhoma jo me pak se 22 m² në rastet kur vendosen 6 veta në dhomë dhe 10m² në rastet kur vendosen 2 veta në dhomë. Gjithashtu, dhomat më të vogla se 6m² nuk plotësojnë standardet minimale për një dhomë burgu dhe duhet të nxirren jashtë shërbimi”*.

Ndonëse numri i përgjithshëm nuk ishte mbi kapacitet, disa sektorë rezultojnë me mbi kapacitet.

Gjendja e popullimit në I EVP Burrel për 6-mujorin e fundit paraqitet si më poshtë

- ***Muaji Shkurt 72 paraburgosur 86 dënuar totali 158***
- ***Muaji Mars 66 paraburgosur 84 dënuar totali 150***
- ***Muaji Prill 70 paraburgosur 80 dënuar totali 150***
- ***Muaji Maj 81 paraburgosur 84 dënuar totali 165***
- ***Muaji Qershor 81 paraburgosur 83 dënuar totali 164***
- ***Muaji Korrik 83 paraburgosur 72 dënuar totali 155***

Organika e I.E.V.P Burrel është e përcaktuar në Urdhrin Nr.43 datë 25.3.2021, të Kryeministrit “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe institucioneve në varësi të saj”, dhe përbëhet nga 145 punonjës nga të cilët 121 ishin punonjës policie dhe 24 punonjës civil. Duke iu referuar strukturës të miratuar të I EVP Burrel, ajo nuk ishte e plotësuar, konkretisht mungonte 1 përgjegjës sektori i burimeve njerëzore dhe shërbimeve si dhe mjeku në institucion ishte part time.

Në bashkëbisedimin me drejtorin e këtij institucioni, grupi inspektues kërkoi një informacion të përgjithshëm mbi gjendjen e respektimit të të drejtave dhe trajtimin e të dënuarve/ paraburgosurve nga ana e stafit dhe punonjësit e policisë së institucionit, si dhe mënyrën e trajtimit dhe adresimit të problematikave pranë organeve eprore, për zbatimin e rekomandimeve të Institucionit të Avokatit të Popullit nga inspektimi i mëparshëm².

¹ Neni 3 i Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, si dhe neni 30 e Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve.

² Rekomandimi: K4/I 60-3 dt.07.05.2021. Kthim përgjigje D.P.Burgjeve: Nr.4835/1 dt 31.08.2021.

- Ishte zbatuar pjesërisht rekomandimi për rikonstrukcionin të I EVP Burrel, duke kryer riparime, mirëmbajtje, eliminim lagështire dhe lyrje të dhomave të të dënuarve.
- Ishte zbatuar rekomandimi për vënien në zbatim të skemës së rimbursimit të ilaçeve për të gjithë të dënuarit/paraburgosurit edhe për sëmundjet akute.
- Ishte zbatuar rekomandimi për ofrimin e shërbimit lavanterisë nga institucioni për veshjet dhe rrobat personale për të dënuarit/paraburgosurit.
- Ishte zbatuar rekomandimi për përmirësimin e sistemit të trajtimit të kërkesave në institucion, duke kthyer përgjigje me shkrim të paraburgosurve ose të dënuarit brenda afatit ligjor.
- Ishte zbatuar rekomandimi për sigurimin e ngrohjes me vënin në funksion të kaldajës me kohë të pjesshme për ngrohje të ambientit si dhe lejimi i rezistencave në gjithë sektorët të I EVP Burrel.
- Ishte zbatuar rekomandimi për kryerjen e konsultimeve më të shpeshta për të dënuarit me shqetësime të shëndetit mendor, në mënyrë që të rivlerësohet dhe saktësohet diagnoza dhe mjekimi përkatës.
- Ishte zbatuar rekomandimi për shtimin e një pajisje telefonike në korridoret e seksionit të paraburgimit.

Ndërkohë që një pjesë e rekomandimeve të mëparshme të paraqitura nga Avokati i Popullit nuk kishin gjetur zbatim dhe nuk ishin plotësuar sipas informacionit të marrë nga drejtuesi i institucionit.

Më konkretisht:

- Nuk ishte zbatuar rekomandimi për të siguruar që të gjithë të dënuarit/paraburgosurit të pajisen me sasinë e mjaftueshme të produkteve bazë të higjienës personale (përfshirë pastë dhëmbësh, furçë dhëmbësh, shampo etj.) si dhe me materialet e nevojshme për të pastruar dhomat e tyre.
- Nuk ishte zbatuar rekomandimi për përmirësimin e kushteve të ambienteve të takimeve me familjarët dhe krijimin e një dhome të veçantë dhe të përshtatshme për takime të të dënuarve me fëmijët e mitur.
- Nuk ishte zbatuar rekomandimi për krijimin e Sektorit të kujdesit të veçantë (SKV).
- Nuk ishte zbatuar rekomandimi për shtimin e aktiviteteve dhe takimeve periodike të stafit me të dënuarit/paraburgosurit për qëllime rehabilitimi, këshillimi, ri-integrimi, si edhe aktivitete edukative e social-kulturore-sportive.

Përgjatë bisedës me titullarin e institucionit u informuam se është ngritur një grup pune për të adresuar të gjithë problematikat dhe gjetjen e zgjidhjeve sa më të shpejta.

Trajtimi i të dënuarve/paraburgosurve

Grupi i inspektimit, kishte për qëllim mbledhjen e informacionit lidhur me garantimin e të drejtave dhe trajtimin e personave që vuajnë dënimin në këtë institucion, identifikimin e rasteve të dhunës, përdorimin e forcës fizike apo ushtrimit të presionit psikologjik ndaj kësaj kategorie, mënyrën e trajtimit dhe zgjedhjes së kërkesë/ankesave të të burgosurve, procedurat që ndiqen nga komisioni për pritjen e tyre në institucion, komisionin për dhënie të masave disiplinore, aktivitetet e zhvilluara, trajtimin shëndetësor të të dënuarve, cilësinë e ushqimit, furnizimin sipas normativës me detergjentë dhe mjete të higjienës personale.

Nga intervistat e zhvilluara me një grup të dënuarish dhe të paraburgosur, grupi i inspektimit nuk evidentoi raste apo pretendime për keqtrajtme dhe tejkalim të forcës fizike nga punonjësit e sigurisë të këtij institucioni. Sikurse ata pohuan në këto intervista, marrëdhëniet e stafit me të burgosurit, janë të mira dhe korrekte. Mekanizmi Kombëtar përgjatë inspektimit u takua dhe me disa të dënuar të cilët më herët kanë bërë ankesa pranë Institucionit të Avokatit të Popullit të cilat janë trajtuar dhe trajtohen me përparësi.

Ankesat nga të dënuarit ishin të shumta në numër :

- Ankesa kishte mbi mungesën e takimeve fizike me familjarët e tyre, pasi një herë në muaj ishte e pamjaftueshme për ta.
- Ankesa kishte në drejtim të cilësisë së gatimit, ashtu dhe në drejtim të larmisë së vakteve.
- Ankesa kishte për mungesën e medikamenteve, sipas tyre institucioni nuk i plotëson kërkesat e tyre për medikamente specifike dhe duhet ti merrnin këto prej familjarëve.
- Ankesa kishte nga të dënuarit dhe të paraburgosurit për shërbimin mjekësor, pasi në I.E.V.P. Burrel nuk ka mjek të punësuar me kohë të plotë.
- Ankesa kishte për mosdhënien e lejeve shpërblyese nga institucioni megjithëse pretendonin se i plotësonin kriteret ligjore, dhe i plotësonin të gjitha kushtet.
- Shqetësim për ta ishte mungesa e aktiviteteve të cilat nuk u janë zhvilluar, të vetmet aktivitete ishin futbollit, lojëra tavoline, domino dhe orari i ajrimit, për arsye të mospërhapjes të sëmundjes infektive COVID-19.

Klasat e edukimit **janë restauruar së fundmi dhe krijojnë mundësi për të zhvilluar aktivitete sociale fetare dhe këshillime individuale.** Ato ndodhen në çdo sektor dhe janë të kompletuara me karrige dhe tavolina, por gjatë periudhës së pandemisë ato kanë qëndruar të mbyllura, për të eliminuar grumbullimet në grupe dhe ruajtur distancimin fizik e social midis të burgosurve. Në kërkesat e parashtruara, të dënuarit dhe të paraburgosurit kërkojnë që klasat të qëndrojnë të hapura edhe në periudhën e pasdites, pasi masat anti COVID-19 janë lehtësuar dhe për popullatën në tërësi. Ndërkohë, janë zhvilluar këshillime individuale dhe është punuar me programe individuale për trajtimin e të burgosurve.

Takimet me familjarë zhvilloheshin 1 herë në muaj por vazhdonin me takimet online nëpërmjet platformës Skype, takime që zgjasnin 20 minuta dhe zhvilloheshin 4 herë në muaj. Në institucion ishin vendosur 2 kompjutera për 152 persona, dhe sipas bisedës me stafin u informuam se çdo fillim muaji ishte miratuar grafiku i cili ju mundësonte të gjithë të dënuarve dhe paraburgosurve që të përcaktonin oraret dhe ditët e komunikimit online. Komunikimi online me familjarët nuk janë ndalur që prej fillimit të pandemisë, dhe nga biseda me të burgosurit ata nuk shfaqën ankesa përse i përket këtij komunikimi online.

Masat mbrojtëse.

Në përputhje me standardet e përgjithshme të të drejtave të njeriut, grupi i inspektimit u njoh dhe administroi kopje të dokumentacionit ku ishin të evidentuara praktikat e punës sipas sektorëve, me qëllim vlerësimin e kushteve dhe trajtimin e personave të dënuar dhe të paraburgosur.

Ekspertët fillimisht morën informacion në lidhje me procedurat e ndjekura për pritjen e të burgosurve në institucion, si dhe funksionimin e Komisionit të Pritjes. Nga intervista e zhvilluar me drejtuesin e institucionit, si dhe nga verifikimi i dokumentacionit grupi i inspektimit konstatoi se, procedura e pranimit në institucion zbatohet në mënyrë korrekte dhe regjistrat e dosjet personale të të burgosurve ishin plotësuar sipas rubrikave.

Vëmendje e veçantë ju kushtua mënyrës si funksiononte sistemi i kërkesë/ankesave. Nga verifikimi dhe inspektimi i dokumentacioneve, rezultoi se kërkesat dhe ankesat e të paraburgosurve ishin të regjistruara në regjistrin përkatës dhe ishin të protokolluara³. Regjistrat mbaheshin nga sekretaria e institucionit.

Të burgosurit pasi plotësonin një formular kërkesë/ankese e dorëzonin më pas te punonjësit e sektorit psiko-social. Punonjësi i sektorit psiko-social i dërgonte formularët në sekretarinë e institucionit ku protokolloheshin dhe pastaj i kalonin drejtorit të institucionit. Në varësi të natyrës të kërkesë/ankesës, sektori përgjegjës i ngarkuar nga drejtori i institucionit i kthente përgjigje me shkrim, ose drejtori/punonjësit e institucionit zhvillonin takime me të burgosurit sipas rastit brenda afatit 3(tre) ditor. Gjatë vitit 2021 ishin evidentuar në regjistër gjithsej 36 kërkesë/ankesa nga të burgosurit.

Sipas shënimeve në regjistër, objekti i kërkesave kishte të bënte me kërkesa për takime me familjarë, kërkesë për takim me avokatë, vizita në spital, ose kërkesë për blerjen e pajisjeve si TV, frigorifer etj.

Sistemi i monitorimit me kamera vëzhgimi ishte funksional. Në I EVP Burrel, gjithësej ndodheshin të instaluar dhe në gjendje pune 86 kamera sigurie, kamerat monitoronin pjesën më të madhe të mjediseve për 24 orë, ndërkohë që të dhënat ruhen në server në institucion për një periudhë 6-14 ditore. Mbikëqyrja me kamera ka një efekt parandalues për veprime të kundërligjshme që mund të kryhen, si nga ana e të dënuarve, ashtu dhe nga vetë punonjësit e policisë së burgjeve. Dokumentimi filmik është një material mbi të cilin mund të konsultohen mjaft të dhëna apo pretendime për trajtimin e të dënuarve dhe të paraburgosurve.

Aparatet e telefonave me kartë, ishin të instaluar në korridoret e secilit prej seksioneve në regjimin e brendshëm. Aparatet e telefonave ishin në gjendje pune dhe nga intervistat me të burgosurit, deklaruan se flisnin me familjarët e tyre rregullisht 2 herë në javë. Por, të burgosurit kërkonin që të shtoheshin kompanitë telefonike, pasi nga dy kompani telefonike që operonin në sistemin e burgjeve, aktualisht është vetëm një kompani, gjë e cila ka sjellë si pasojë që të ulen minutat e bisedës (çmimi i kartës i njëjtë) dhe rreth 50% e aparateve telefonik të jenë të bllokuar dhe nuk funksionojnë.

³ Neni 58 i ligjit nr.81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”.

Në IEVP Burrel, vijonte të mungonte një mjedis i veçantë për të burgosurit, që kishin fëmijë të vegjël për ushtrimin e të drejtës së prindërimit në distancë. Në IEVP Burrel nuk janë marrë masa për rregullimin apo riparimin e dhomës së takimit me fëmijët, pavarësisht se është rekomanduar nga ana e institucionit të Avokatit të Popullit që nga vitin 2017.

Në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale Burrel, sipas organikës ishin të punësuar 17 të dënuar/paraburgosur, nga 21 që parashikohet, në pozicione pune si sanitarë, shpërndarës ushqimi, mirëmbajtës kaldaje, berber, bojaxhi, punonjës biblioteke etj. Të dënuarit që punonin përfitonin nga ulja e dënimit dhe dhënia e përfitimit monetar, në masë minimale, që depozitohej në numrin e llogarisë të personit sipas kontratës së punës, për të cilën shpërblehen sipas dekretit të vitit 1988, ku u njihet e drejta për të përfituar 90 lekë të rinj në muaj.

Punësimi i të paraburgosurve/dënuarve parashikohet në nenet 43 dhe 44 të Ligjit Nr. 81/2020, “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”. Në nenin 44 të ligjit të cituar më sipër parashikohet se: “1. I burgosuri ka të drejtën e një shpërblimi mujor për punën e tij. Shpërblimi për secilën kategori caktohet në vlerë të drejtë në proporcion me sasinë dhe cilësinë e punës së kryer dhe organizimin e punës që rregullohet me vendim të Këshillit të Ministrave. 2. I burgosuri ka të drejtë të disponojë lirshëm dyzet për qind të të ardhurave të fituara nga puna.”

Megjithëse në nenin 91 të këtij ligji parashikohet miratimi nga Këshilli i Ministrave i akteve nënligjore në zbatim të tij brenda gjashtë muajve nga hyrja në fuqi, deri më tani nuk është nxjerrë e miratuar VKM-ja lidhur me kriteret për shpërblimin e punës së të dënuarve dhe të paraburgosurve.

Avokati i Popullit thekson se puna dhe kriteret e shpërblimit duhet të parashikohen dhe rregullohen me Vendim të Këshillit të Ministrave, vendim i cili edhe pse tej çdo afati ligjor, ka shumë vite që nuk është miratuar. Në vijim, u miratua Vendimi i Këshillit të Ministrave me nr. 602, datë 13.10.2021 “***Për përcaktimin e rregullave të posaçme për punësimin e të burgosurve, kushtet e punës, kohëzgjatjen dhe shpërblimin e saj***” i cili pritet të zbatohet në vijim nga organet përkatëse.⁴

Kushtet materiale

Grupi i monitorimit, kishte në fokus të vizitës inspektuese plotësimin e kushteve materiale, si një prej elementeve shumë të rëndësishëm të respektimit të standardeve të jetesës për të burgosurit.

Ndërtesa e kësaj IEVP-je, përveç se është e amortizuar, nuk i plotëson kushtet e përshtatshme higjienike e fizike për strehimin e të dënuarve sipas standardeve të përmbajtura në legjislacionin shqiptar por edhe ato të përcaktuara nga CPT. Sipas informacionit, gjatë viteve të fundit, në këtë IEVP janë bërë investime për eliminimin e lagështirës në të 3 sektorët në shumën 10.000.000 lekë. Pavarësisht investimeve, gjendja teknike e godinave të banimit vijon të jetë e amortizuar dhe lagështira të jetë prezente më

⁴ Vendimi i Këshillit të Ministrave me nr. 602, datë 13.10.2021 “***Për përcaktimin e rregullave të posaçme për punësimin e të burgosurve, kushtet e punës, kohëzgjatjen dhe shpërblimin e saj***” i cili pritet të zbatohet në vijim nga organet përkatëse.

së shumti në ambientet e katit të parë të godinave përkatësisht sektori/A siguria e zakonshme.

Paraqitja e popullimit në sektorë:

- ✓ Sektori A siguri e zakonshme 9 dhoma me 5-6 banorë
- ✓ Sektori A1 siguri e lartë 12 dhoma me nga 1 banor
- ✓ Sektori B siguri e zakonshme me 8 dhoma, përgjatë inspektimit e boshatisur për shkak se po përshtatej për tu kthyer në siguri të lartë.
- ✓ Sektori B1 siguri e lartë me 7 dhoma banimi dhe 2 dhoma infermiera dhe dhoma e stomatologut.
- ✓ Sektori C paraburgimi 13 dhoma banimi me 6-10 banorë
- ✓ Sektori C1 dhoma 1 observim, dhoma 2 izolim, dhoma 3 izolim

Përsa më sipër, situata në IEVP Burrel është jashtë standardeve, kushtet janë të papërshtatshme dhe me gjithë rekomandimet e vazhdueshme për përmirësimin e kësaj situatë, nuk ka përmirësime të tilla që bëjnë të mundur jetesën dinjitoze për të burgosurit.

Komiteti European për Parandalimin e Torturës (CPT) rekomandon që të ndërmerren masa nga autoritetet shqiptare për të bërë që kushtet e përgjithshme të akomodimit të të dënuarve në burgun e Burrelit të arrijnë një standard të pranueshëm. Kjo do të kërkojë edhe marrjen e masave për të reduktuar lagështirën nëpër qeli duke përmirësuar ventilimin, duke vendosur një sistem funksional të plotë ngrohje në qeli etj. Institucioni i Avokatit të Popullit, ashtu dhe CPT, ndër të tjera kanë vënë theksin se të rekomandohet që të ndërmerren hapa urgjent për të rregulluar kushtet nëpër qelitë e IEVP Burrel⁵.

Dhomat e banimit kanë kapacitet për akomodimin e 4 personave. Hapësira dhe sipërfaqja e dhomave është e mjaftueshme për jetesë normale dhe dritaret sigurojnë ajrim dhe dritë të plotë natyrale. Çdo dhomë ka tualetin e saj, ndërsa dushet janë të përbashkëta në çdo seksion. Dhomat dhe ambientet e tjera kanë energji elektrike, që furnizohet nga rrjeti elektrik i institucionit. Institucioni gjithashtu ka burim energjie rezervë me gjeneratorë, për furnizimin me energji elektrike në rast ndërprerjeje. Për shkak të përshtatjes të sektorit të sigurisë së zakonshme në siguri të lartë disa nga dhomat kishin mbipopullim të burgosurish të cilat ishin me 8-9 persona në dhomë.

Furnizimi me ujë, ishte 4 orë në ditë. Të dënuarit shfaqën ankesa që ky shërbim kishte probleme thelbësore dhe nuk plotësoheshin nevojat e tyre.

Ushqimi për të dënuarit dhe të paraburgosurit gatuhet në kuzhinën e institucionit, e cila ishte e madhe. Në kuzhinë ndodhej regjistri i gramaturave, menyja ditore dhe kampionët e ushqimit të gatuar një ditë më parë, të ruajtura në kushte frigoriferike, si dhe librezat shëndetësore të personelit të kuzhinës. Gatimi i ushqimit kryhet sipas kategorive më vete për të burgosurit, për të punësuarit dhe për të sëmurët kronikë dhe furnizimi dhe gatimi i ushqimit sipas vakteve për të burgosurit, bëhet rregullisht. Në intervistat me të dënuarit

⁵ <https://rm.coe.int/168097986b> Report to the Albanian Government on the visit to Albania carried out by the European Committee for the Prevention of Torture and Inhuman or Degrading Treatment or Punishment (CPT) from 20 to 30 November 2018

dhe të paraburgosurit, pati ankesa lidhur me cilësinë e gatimit të ushqimit, por më së shumti për larmishmërinë e tij.

Gjithashtu, furnizimi dhe përmirësimi për pajisjen me sasi të mjaftueshëm të produkteve bazë të higjienës personale si p.sh. pastë dhëmbësh, furçë dhëmbësh, shampo dhe materialet e nevojshme për të pastruar dhomat e tyre ishin të pamjaftueshme sipas furnizimit mujor për të dënuarit dhe të paraburgosurit në I.E.V.P. Burrel.

Regjimi dhe aktivitetet

Regjimi dhe aktiviteti i të dënuarve dhe të paraburgosurve, ishte i përcaktuar në orarin e veprimeve ditore të miratuar nga titullari i këtij institucioni. Orari i veprimtarive ishte i njëjtë për të gjithë sektorët, pavarësisht nga siguria që ata kanë dhe aktivitetet që zhvillojnë.

Në IEVP Burrel ofroheshin shumë pak aktivitete, kjo edhe për shkak të mungesës së hapësirave dhe kufizimeve të emergjencës shëndetësore. Biblioteka ishte shumë e varfër, në tituj e sasi librash. Sikurse u përmend edhe më lart, në intervistat me të burgosurit u ngrit si shqetësim ndërprerja e aktiviteteve në grup apo atyre me pjesëmarrje të gjerë, për shkak të gjendjes së pandemisë. Pavarësisht këtyre masave, një ndër qëllimet e institucioneve të mbyllura penitenciare është riintegrimi në shoqëri i personave.

Në këtë kuadër, Mekanizmi Kombëtar, thekson nevojën që sektori psiko-social të hartojë programe aktivitete për trajtimin individual të këtyre personave sipas grup moshave, të ndërthurura me zhvillimin e aktiviteteve me grupe sa më të vogla personash, me qëllim që ata të kenë mundësi të ndërveprojnë me njëri tjetrin, si dhe të mbushin sado pak atë boshllëk psikologjik dhe edukativ, që krijohet te këta persona nga mungesa e aktiviteteve kulturore dhe sportive me botën jashtë, gjatë kësaj periudhe.

Në lidhje me kohëzgjatjen e ajrimit, të dënuarit/ paraburgosurit nuk kishin ankesa. Ata ishin të kënaqur me oraret e ajrimit, të cilat ishin në përputhje me standardet dhe rregulloren e institucionit. Dyert e dhomave mbaheshin hapur për ajrim prej orës 07⁰⁰ - 19⁰⁰. Ndërkohë, ambientet e ajrosjes lejoheshin të përdroreshin nga të paraburgosurit vetëm për aktivitete sportive, por këto të fundit mund të siguroheshin me radhë, vetëm për ata që bënin kërkesë.

Në ambientet e paraburgimit kishte dhomë kulti. Në IEVP Burrel kishte një ambient të përshtatshëm që shërbente si sallë për ushtrimin e riteve fetare. Të dënuarit kryenin rregullisht ritet fetare por edhe rite të veçanta. Nuk kishte dhomë këshillimi në seksione.

Për sa i përket mbështetjes psiko-sociale që merrnin të burgosurit, vihej re se kishte kontakte të shpeshta të të dënuarve/ paraburgosurve me punonjësit përkatës të kujdesit social por mungesa e kushteve të përshtatshme për dhënie të këtij shërbimi mbetej problem thelbësor. Gjithsesi, problematike mbetet mungesa e dhomës dhe ambienteve të përshtatshme për këshillim individual, mungesë e cila kufizonte përfshirjen në procesin e rehabilitimit.

Shërbimet shëndetësore

Personeli i kujdesit në Institucionin Ekzekutimeve të Vendime Penale Burrel përbëhet nga 7 persona, 1 mjek me kohë të pjesshme i cili punonte 4 orë çdo ditë, 4 ndihmës mjekë, 1 stomatolog dhe 1 farmacist.

Nga intervistat me të dënuarit/paraburgosurit problematika më shqetësuese ishte mungesa e mjekut në institucion. Mungesa e mjekut me kohë të plotë, kishte sjellë për pasojë vonesa të përgjigjeve ndaj kërkesave për vizita mjekësore, si dhe për konsultat jashtë institucionit me mjekë specialiste në spitalin e rrethit, dhe më shqetësuese është mungesa e mjekut në situata emergjente, kohë kur mund të ketë situata të rënduara në shëndetin nga të dënuarit.

Problematikat më të shumta që u konstatuan në këtë institucion përsa i përket shërbimit shëndetësor, ishin të lidhura kryesisht me mungesën e medikamenteve për mjekimet, të cilat shpesh mbuloheshin me ilaçe që silleshin nga familja, pasi vetë institucioni kishte mangësi të theksuara të ilaçeve. Skema e furnizimit me ilaçe funksiononte vetëm për të sëmurët kronikë, të tjerët furnizoheshin me ilaçe të sjellë nga familja.

Sipas informacionit që morëm nga drejtori i I EVP- në këtë I EVP vuanin dënimin 13 persona me çrregullime të shëndetit mendor. Nga këqyrja e dokumentacionit të stafit mjekësor, u konstatua ekzistenca e një regjistri vizitash themeltar, regjistri i të sëmurëve kronike, si dhe regjistri për konsultat që mbahen jashtë institucionit. Të gjithë formatet e kontrollit mjekësor ishin të mbajtura me rregull, po ashtu edhe regjistrat e informacionit 24 orësh të infermierëve. Ky institucion referuar numrit të lartë të personave me probleme të shëndetit mendor, ka problem thelbësor mos prezencën e një mjeku psikiatër për vizita periodike. Duke marrë shkas nga numri i lartë i të sëmurëve, specifika institucionale dhe dinamika e lartë e problematikave tek të paraburgosurit/dënuarit lidhur me gjendjen e tyre emocionale apo problemet e mbartura gjatë vuajtjes së dënimit në një kohe relativisht të gjatë, prezenca e psikiatrit ishte e domosdoshme pasi mund të ndihmojë në parandalimin e agravimit të gjendjes të shëndetit të tyre mendor. Gjithashtu kishte edhe persona të tjerë të cilët vuanin nga sëmundje kronike cilët trajtoheshin nga stafi mjekësor i institucionit me medikamente, sipas rekomandimeve të mjekëve specialist të spitalit civil të Burrelit. Gjithashtu dhoma e mjekut ishte e rregullt, e pastër, e mirëmbajtur dhe e pajisur me një krevat vizitash, një dollap ku mbaheshin ilaçet e urgjencës.

Dhoma e infermierisë sipas informacionit të dhënë, ndodhej brenda në regjim në sektorin B1, dhe shfrytëzohej për vizitat e mjekësore. Dhoma ishte e pajisur me dy shtretër, tavolinë, ndërsa mjekimet e urgjencës mbaheshin në një çantë e cila shërbente edhe për sektorët e tjerë, duke qenë se këta të fundit nuk kishin një dhomë infermierie. Farmacia e këtij institucioni është e rregullt dhe e pajisur me ilaçe për sëmundjet kronike, por mungonin ato për sëmundjet akute.

Skema e rimbursimit të ilaçeve ishte funksionale vetëm për sëmundjet kronike, por ajo nuk gjente zbatueshmëri për sëmundjet akute, megjithëse ky është një detyrim që rrjedh nga kontrata tre palëshe midis Fondit të Sigurimeve të Detyrueshme të Kujdesit Shëndetësor, I EVP-së dhe Depos Farmaceutike përkatëse.

Për sa më sipër dhe në mbështetje të pikës 3, të nenit, 63 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku thuhet se: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike”*; të nenit 21, gërma “b” të ligjit nr. 8454 dt. 04.02.1999 *“Për Avokatin e Popullit”*, i ndryshuar, ku thuhet se: *“Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të*

së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive; si dhe në bazë të Nenit 81/1 pika 2/b të ligjit Nr.81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, i ndryshuar ku parashikohet midis të tjerash se: “Avokati i Popullit nëpërmjet Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës ka këto kompetenca: të paraqesë rekomandime për organet përkatëse, me qëllim që të përmirësohet trajtimi dhe kushtet e individëve që u është hequr liria dhe të parandalohet tortura dhe trajtimi ose dënimi i egër, çnjerëzor dhe poshtërues”.

REKOMANDOJMË:

1. Marrjen e masave të menjëhershme për uljen e mbipopullimit në IEVP Burrel.
2. Marrjen e masave të menjëhershme për përmirësimin e cilësisë dhe larmisë së ushqimit.
3. Marrjen e masave të menjëhershme për plotësimin e pozicioneve të mjekut me kohë të plotë në institucion, sipas parashikimeve në organikën e I.E.V.P Burrel.
4. Marrjen e masave të menjëhershme për krijimin e Sektorit të Kujdesit të Veçantë (SKV) në IEVP Burrel.
5. Marrjen e masave për të siguruar që të gjithë të dënuarit/paraburgosurit të pajisen me sasinë e mjaftueshme të produkteve bazë të higjienës personale (përfshirë pastë dhëmbësh, furçë dhëmbësh, shampo, etj.) si edhe me materialet e nevojshme për të pastruar dhomat e tyre.
6. Marrjen e masave të menjëhershme për vënien në zbatim të skemës së rimbursimit të ilaçeve për të gjithë të dënuarit/paraburgosurit edhe për sëmundjet akute.
7. Marrjen e masave për përmirësimin e kushteve të ambienteve të takimeve me familjarët dhe krijimin e një dhome të veçantë dhe të përshtatshme për takime të të dënuarve me fëmijët e mitur.
8. Marrjen e masave për punësimin me kohë të pjesshme të një mjeku psikiatër.
9. Marrjen e masave për kryerjen sa më parë të investimeve, riparimin dhe eliminimin e lagështirës në dhomat e banimit të të burgosurve.
10. Marrjen e masave për sigurimin e vaksinimit për të gjithë të dënuarit dhe paraburgosurit me qëllim rruajtjen e shëndetit dhe kthimin e aktiviteteve dhe jetës sociale brenda I.E.V.P-së Burrel.

Për qëndrimin dhe masat që do të merrni në zbatim të këtij rekomandimi, të vihemi në dijeni brenda afatit 30 ditor sipas nenit 22 të Ligjit Nr. 8454 dt. 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj.

KOMISIONER

ERMONELA XHAFA